

NJOFTIM-SHPREHJE INTERESI

FTESË PËR APLIKIM PËR DISENJIMIN E LOGOS ME RASTIN E 20 VJETORIT TË BQK-së

Data: 21.02.2019

Nr. i Prokurimit: BQK 19 011 241

LËNDA DHE PËRSHKRIMI

Titulli i kontratës: DISENJIMIN E LOGOS ME RASTIN E 20 VJETORIT TË BQK-së.
Lloji i prokurimit: Shërbime –Shprehje Interesi
Vendi kryesor i realizimit: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK)

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës fton të gjithë të interesuarit që të bëhen pjesë e garës për disenjimin e Logos që do të përdoret me rastin e shënimit të 20 vjetorit të BQK-së.

Vlerësimi i propozimeve do të bëhet nga komisioni i themeluar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

Logoja e zgjedhur do të përdoret për shënimin e të gjitha aktiviteteve që do të organizohen me rastin e 20 vjetorit të themelimit të BQK-së, si dhe do të figurojë në faqen e internetit të BQK-së, në materiale komunikuese, publikime dhe në çdo aktivitet që BQK e vlerëson të nevojshme.

Kriteret lidhur me dizajnimin e logos së BQK-së janë :

- Të jetë kuptimplotë dhe të shprehë funksionin, mandatin dhe detyrat e BQK-së
- Logoja duhet të ketë një pasqyrim artistik të veprimtarisë së BQK-së
- Të jetë unike, të reflektojë vizionin, misionin dhe vlerat e BQK-së.
- Duhet të kuptohet lehtësisht.
- Duhet të përçojë mesazh të qartë për 20 vjetorin e BQK-së.
- Të jetë e dallueshme, që i reziston kohës dhe e lehtë për tu mbajtur në mend.
- Duhet të jetë lehtë e përshtatshme për t'u vendosur në dokumente fizike dhe në paraqitje elektronike, në internet dhe në shtyp, në sfonde të bardha dhe të errëta.
- Të jetë e përshtatshme për t'u përdorur në dimensione të ndryshme (si për shembull, në kartëvizita dhe billboarda)

Propozimi i logos duhet të dorëzohet në pliko të mbyllur me emër të personit fizik ose juridik në CD, bashkë me një version vektor të logos dhe po ashtu e shtypur në kopje fizike. Së bashku me propozimin e logos, duhet bashkëngjitur edhe një manual i shpjegimeve të përmbajtjes dhe përdorimit.

Konkursi është i natyrës garuese dhe ideja më e mirë e përzgjedhur do të shpërblehet me 1500 €.

Të drejtat e autorit për propozimet e përzgjedhura barten nga propozuesi te BQK-ja.

Kushtet për aplikim me propozime:

Të drejtë aplikimi me propozime për logon kanë personat fizik dhe juridik.

Propozimet duhet të dorëzohen në letër dhe në formë.

Në rast te aplikimit si Operator Ekonomik/person juridik, atëherë operatori ekonomik/personi juridik duhet të dorëzojë regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në shtetin e themelimit të operatorit ekonomik;

Në mënyrë që të dëshmohet se është i përshtatshëm, personi fizik duhet te dorëzojë letërnjoftimin.

Kushtet për dorëzimin dhe informatat tjera;

Punimet duhen të jenë në pliko të mbyllura dhe të kenë shifrën “Logo për 20 vjetorin e themelimit të BQK-së”

Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve: 28.02.2019 ora 14:00 në arkivin e Bankës Qendrore të Kosovës.

Afati për sqarime shtesë: më së largu deri më 25.02.2019 në ora 14:00, në email adresën prokurimi@bqk-kos.org .

ADRESA:

Rr. Garibaldi nr. 33	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): www.bqk-kos.org	
Personi kontaktues: Divizioni i Prokurimit	E-maili: prokurimi@bqk-kos.org
Telefoni: 038 222 055/452	Fax: 038 243 763